

AGJENDA

MATJA E MOSPËRPUTHJES SË SHKATHTËSIVE

TAKIM ONLAJN

25 nëntor 2021, ora: 09:30 – 12:30 (sipas kohës së Evropës Qendrore)

HYRJE

Fondacioni Evropian për Trajnime (ETF) ka filluar që në vitin 2020 një nismë për matjen e frekuencës së mospërputhjes së shkathtësive në vendet fqinje të BE-së dhe në Azinë Qendrore (vendet partnere të ETF-së).

Vlerësimi i mospërputhjes së shkathtësive në vendet partnere shpuri në këto rezultate:

- Zhvillimin e një sërë treguesve të mospërputhjeve të mundshme duke u bazuar në hulumtimet e mëparshme të ETF-së për këtë temë (2017-2018), grupet e të dhënave në dispozicion në rreth 20 vende partnere, udhëzimet lidhur me matjen e mospërputhjes së shkathtësive të miratuara nga Konferenca e 18-të ndërkombëtare e statistikienëve të punës (Organizata Ndërkombëtare e Punës), dhe hulumtime të ngjashme të kryera nga Eurostat, Qendra Evropiane për Zhvillimin e Aftësimin Profesional (CEDEFOP) dhe Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD).
- Llogaritjen e treguesve të mospërputhjes së shkathtësive, me fokus në shkëputjen nga shkolla dhe tregu i punës, si dhe në mospërputhjet sipas nivelit të arsimit (vertikal) dhe fushës së studimit (horizontal). Përveç kësaj, janë marrë parasysh grupmoshat përkatëse (të rinjtë kundrejt të rriturve) dhe llojet e arsimit (terciar kundrejt të mesëm; profesional kundrejt të përgjithshëm) për të siguruar prova përkatëse për politikëbërje.
- Rishikimin e të dhënave në dispozicion dhe të rekomandimeve për përshtatje metodologjike lidhur me harmonizimin e plotë të klasifikimeve kombëtare të arsimit me standardet ndërkombëtare në terren; dhe rritjen e ndjeshmërisë së statistikave ndaj llojeve dhe programeve të ndryshme arsimore.

Puna e ETF-së mbi mospërputhjen e shkathtësive është modeluar në kuadër të përpjekjeve të përgjithshme për të krijuar shkathtësi dhe inteligjencë për tregun e punës në vendet fqinje të BE-së dhe në Azinë Qendrore; dhe për ta rritur rëndësinë e arsimit dhe aftësimin fillestar dhe të vazhdueshëm. Kjo është në përputhje me prioritetet strategjike të Bashkimit Evropian¹ për të investuar në zhvillimin e shkathtësive dhe të punonjësve në terren, punëkërkesve dhe grupeve të tjera të ekspozuara ndaj vjetërsimit të shkathtësive si rezultat i

¹ Siç përcaktohet në Agjendën evropiane për shkathtësi <https://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=1223&langId=en> dhe Shtylla Evropiane për të drejtat sociale https://ec.europa.eu/info/strategy/priorities-2019-2024/economy-works-people/jobs-growth-and-investment/european-pillar-social-rights_en

ndryshimeve të thella në kërkesën dhe ofertën për shkathtësi dhe tranzicioneve të përshpejtuara të tregut të punës.

Objektivat e këtij takimi janë:

- të ndahen rezultatet e llogaritjes së mospërputhjeve duke përdorur grupe të të dhënave të përzgjedhura (d.m.th. anketën mbi fuqinë punëtore) dhe të diskutohen metodat kryesore metodologjike në rreth 20 vende pjesëmarrëse,
- të nxitet një shkëmbim mbi zhvillimet më të fundit ndërkombëtare dhe evropiane të rëndësishme për vlerësimin e mospërputhjes së shkathtësive dhe implikimeve për veprimet e politikave në fushat e arsimit, (ri)aftësimit dhe punësimit,
- të shqyrtohen mundësitë e ardhshme për hulumtimin dhe zgjerimin e njohurive, si dhe për ngritjen e kapaciteteve në fushën e inteligjencës së shkathtësive dhe të shpihen përpara mundësitë për bashkëpunim me ETF-në dhe me organizata të tjera ndërkombëtare dhe evropiane.

Gjuhët e punës: anglisht, arabisht, rusisht, shqip, serbisht/boshnjakisht/kroatisht/malazisht, maqedonisht, turqisht.

E ENJTE, 25 NËNTOR 2021

09:30 – 09:45	Hapja e sesionit Fjala hyrëse Cesare Onestini, drejtor, ETF Manuela Geleng, drejtoreshë, Punë dhe shkathtësi (EMPL.B), Drejtoria e përgjithshme për punësim, çështje sociale dhe gjithëpërfshirje, Komisioni Evropian
09:45 – 10:45	Matja e mospërputhjes së shkathtësive – qasjet dhe rezultatet
	<p><i>Gjetjet kryesore dhe perceptimet e hulumtimit mbi mospërputhjen e shkathtësive në vendet partnere të ETF-së</i></p> <p>Ben Kriechel, hulumtues i lartë, Economix Research & Consulting, Gjermani</p> <p style="text-align: center;"><i>Pyetje dhe përgjigje</i></p> <p>Diskutim në panel:</p> <p><i>Perceptimet nga vendet mbi frekuencën e mospërputhjes së shkathtësive</i></p> <p>Irma Gvilava, Shef i Departamentit të Statistikave të Punës, Shërbimi Gjeorgjian për Statistikat Kombëtare</p> <p>Milijana Smiljkovic, Divizioni për statistikave të tregut të punës, Enti statistikor i Republikës së Serbisë</p> <p>Mark Feldman, zëvendës drejtor i Departamentit të lartë mikroekonomik, Zyra qendrore e statistikave, Izrael</p> <p><i>Lehtësuese: Cristina Mereuta, eksperte për zhvillimin e kapitalit njerëzor, ETF</i></p>
10:45-10:50	<i>Pushim</i>
10:50-12:15	Praktikat ndërkombëtare dhe evropiane të hulumtimit dhe gjetjet e politikave mbi mospërputhjen e shkathtësive
	<p><i>Perceptime të politikave mbi vlerësimin e mospërputhjes së shkathtësive: mësim nga Anketa e OECD-së mbi shkathtësitë e të rriturve (PIAAC) dhe Anketa evropiane për shkathtësi dhe punë (Cedefop)</i></p> <p>Glenda Quintini, ekonomiste e lartë, Drejtoria për punësim, punë dhe çështje sociale, OECD</p> <p>Konstantinos Pouliakas, ekspert, Departamenti për shkathtësi dhe treg të punës, CEDEFOP</p> <p style="text-align: center;"><i>Pyetje dhe përgjigje</i></p> <p><i>Statistikat eksperimentale mbi mospërputhjen e shkathtësive në Bashkimin Evropian</i></p> <p>Georgiana Ivan, zyrtare për statistika, EUROSTAT</p> <p><i>Matja e mospërputhjes së kualifikimeve dhe shkathtësive – implikimet metodologjike dhe sfidat për Organizatën Ndërkombëtare të Punës</i></p> <p>Valentina Stoevska, stacione e lartë, Departamenti i statistikave, ONP (të konfirmohet)</p>

	<p><i>Matja e shkathtësive të të rriturve në vendet në zhvillim: perceptime nga Programi i Bankës Botërore për matjen e shkathtësive (STEP)</i></p> <p><i>Alexandria Valerio, specialiste kryesore për arsim, Banka Botërore</i></p> <p><i>Pyetje dhe përgjigje</i></p> <p><i>Lehtësuese: Mircea Badescu, statisticiene e zhvillimit të kapitalit njerëzor, ETF</i></p>
<p>12:15 – 12:30</p>	<p>Fjala përmbyllëse</p> <p>Manuela Prina, shefe e Njësisë për identifikimin dhe zhvillimin e shkathtësive, ETF</p>